



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1579 prot.

Tiranë, më 16.11. 2021

V E N D I M

Nr. 222, datë 16.11.2021

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹”*, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën me nr. 131 Regj., datë 21.07.2021, të A. Gj, kundër Bashkisë së Lezhës, me pretendimin e diskriminimit për shkak të *“bindjeve politike³”*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, A. Gj, shprehet se: *“Në vitin 2015 kam filluar punë pranë Bashkisë Lezhë, në pozicionin e specialistit të marrëdhënieve me publikun, detyrë të cilën e kam kryer për 4 vite, deri në muajin gusht 2019, kur është emëruar kryetari i ri i Bashkisë, P. N. Me ardhjen e P. N në krye të Bashkisë, jam larguar nga puna në mënyrë verbale, duke m'u komunikuar se po largohem pasi i përkas Partisë Demokratike dhe drejtimi i institucionit u mor nga P.N, i cili i përket Partisë Socialiste”*.

Subjekti ankues është shprehur se nuk disponon asnjë dokument të largimit të tij nga puna dhe se nuk është njoftuar konform rregullave ligjore për largimin e tij nga puna.

Ankuesi ka pretenduar se sjelljet diskriminuese kundrejt tij e kanë burimin tek bindjet e tij politike, pasi ka bindje të kundërta me ato të Kryetarit aktual të Bashkisë, ndërsa personalisht është aktivist dhe anëtar i Partisë Demokratike, fakt ky i njohur nga të gjithë.

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

³ Referuar kartës së anëtarësimit në subjektin politik Partia Demokratike (PD), lëshuar me datë 03.03.2015, ankuesi ka provuar bindjet e tij politike.

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të konstatojë diskriminim të tij për shkak të bindjeve politike, nga ana e Bashkisë Lezhë, si dhe rikthimin në vendin e mëparshëm të punës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së⁴, i ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”*.

Bazuar në nenin 32/1/a të LMD-së, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010, i ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 1103/1 prot., datë 02.08.2021 Komisioneri ka njoftuar dhe i ka kërkuar parashtrime, subjektit kundër të cilit është paraqitur ankimimi, Bashkisë Lezhë, lidhur me pretendimin e subjektit ankues.

⁴Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

Në vijim, Bashkia Lezhë, ka njohur Komisionerin lidhur me qëndrimin e saj, si dhe ka bashkëlidhur një pjesë të dokumentacionit të kërkuar, në cilësi prove.

Kështu:

- Nëpërmjet shkresës me nr. 14554/1 prot., datë 17.08.2021, Bashkia Lezhë, ka parashtruar se:

“Marrëdhënia e punës mes A. Gj dhe Bashkisë Lezhë ka nisur me kontratën e datës 01.01.2017, në pozicionin “Elektiçist” në Sektorin e Shërbimeve Publike. Kontrata e punës ishte e lidhur midis palëve me një afat të caktuar, nga data 01.01.2017-01.06.2017. Pas përfundimit të afatit të kontratës nuk është bërë kontratë e re, por kontrata e punës është zgjatuar në heshtje dhe z. Gj ka ushtruar këtë detyrë deri më datë 03.08.2017, pasi me Vendimin nr. 309, datë 03.08.2017 “Për emërimin e A. Gj”, të Kryetarit të Bashkisë, është emëruar “Punëtor” në Sektorin e Mirëmbajtjes së Institucioneve, në Agjencinë e Shërbimeve Publike, pranë Bashkisë Lezhë. Këtë detyrë e ka ushtruar deri më datë 03.10.2017, pasi me Vendimin nr. 387, datë 03.10.2017, z. Gj është transferuar nga detyra “Punëtor” në Sektorin e Mirëmbajtjes së Institucioneve dhe është komanduar në “Punonjës” në Agjencinë e Emergjencave Civile, pranë Bashkisë Lezhë. Këtë detyrë e ka mbajtur deri më datë 16.09.2019, pasi me Urdhrin nr. 472, datë 16.09.2019 “Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës”, është liruar nga detyra, për shkaqe të justifikuara, pasi kishte më shumë se 30 ditë që nuk ishte paraqitur në punë dhe nuk kishte lajmëruar për ndonjë arsye të mosparaqitjes në punë. Urdhri më sipër, i është njoftuar në vendin e punës, me datë 16.09.2019.

Gjatë muajit gusht 2019 dhe 15 ditëshit të parë të muajit shtator 2019, pa asnjë shkak të justifikuar dhe pa njoftuar Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, apo eprorin e tij, z. Gj nuk është paraqitur asnjë ditë në punë. Gjatë kësaj periudhe nga ana e tij nuk është bërë asnjë njoftim për të sqaruar arsyet e mosparaqitjes në punë. Punëmarrësi ka detyrim për t’u paraqitur në punë dhe për të kryer punën për të cilën ka rënë dakord. Mosparaqitja në punë për më shumë se 7 ditë pa një shkak të justifikuar, e punëmarrësit, konsiderohet si shkelje e rëndë e kontratës së punës, por megjithatë, z. Gj nuk është paraqitur në punë për më shumë se 30 ditë, duke braktisur vendin e punës dhe nuk ka njoftuar për ndonjë shkak të arsyeshëm të mosparaqitjes në punë. Marrëdhënia e punës midis Bashkisë dhe z. Gj është zgjidhur nga ky i fundit duke mos u paraqitur në punë për më shumë se 30 ditë dhe nuk mund të pretendohet për zgjidhje të marrëdhënies së punës nga ana e Bashkisë në mënyrë abuzive apo për motive politike.

.....Në dosjet e punonjësve të Bashkisë nuk disponohen të dhëna për përkatësinë fetare, politike, etnike apo të dhëna të tjera që nuk përfshihen në informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar nga ligji. Ne nuk kemi dijeni dhe nuk mbajmë të dhëna për përkatësinë politike të punonjësve tanë, pasi një gjë e tillë është në kundërshtim me ligjin. Përkatësia politike e ankuesit nuk ka qenë shkak për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, pasi nga ana e Bashkisë përkatësia e tij politike nuk ka qenë e ditur dhe nuk duhej të kishte qenë e ditur, pasi nuk është një informacion që mbledhet nga Burimet Njerëzore të Bashkisë”.

Lidhur me informacionin e kërkuar nga KMD, nëse në vend të ankuesit është emëruar një punonjës tjetër, Bashkia ka informuar Komisionerin se, në atë pozicion pune nuk emëruar askush tjetër, dhe se me ristrukturimin që i është bërë Bashkisë në muajin tetor 2019, Agjencia e Emergjencave Civile është shkurtuar plotësisht dhe aktualisht në strukturën e Bashkisë Lezhë nuk ka asnjë pozicion “Punëtor” të Emergjencave Civile.

Emergjencat Civile të Bashkisë Lezhë janë të organizuara në Drejtori dhe të gjithë punonjësit e saj janë me arsim të lartë dhe pozicionet e tyre janë pjesë e shërbimit civil. Rekrutimi i tyre në këto pozicione bëhet sipas parashikimeve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Bashkia Lezhë, informon në vijim se, ankuesi nuk është ankuar për diskriminim pranë Bashkisë dhe zgjidhjen e marrëdhënieve të punës nuk e ka ankimuar as në gjykatë, as për diskriminim, as për ndonjë arsye tjetër.

Po ashtu, Bashkia citon se: *“Që nga muaji korrik 2019, z. Gj nuk është paraqitur asnjë herë pranë këtij Institucioni për të tërhequr dosjen e tij personale apo për të plotësuar librezën e punës dhe nuk ka paraqitur asnjë kërkesë që të ketë lidhje me marrëdhënien e tij të punës. Për pretendimet e tij jemi njohur për herë të parë nëpërmjet shkresës së datës 02.08.2021, të Komisionerit, prandaj këto pretendime janë të pabazuara dhe nuk qëndrojnë”.*

2. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr.10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, më datë 19.10.2021, zhvilloi seancën dëgjimore, të njoftuar paraprakisht.

Seanca u zhvillua vetëm me praninë e përfaqëueses së Bashkisë Lezhë, juristes S. N dhe në mungesë të subjektit ankues.

Përfaqësuesja e Bashkisë depozitoi dokumentacionin e kërkuar nga Komisioneri, si dhe mbajti të njëjtin qëndrim që Bashkia kishte bërë të njohur gjatë komunikimit shkresor me KMD-në dhe që do të shtjellohet, gjatë arsyetimit të vendimit. U la si detyrë për Bashkinë që në vijim të dërgonte informacionin se kur e kishte kryer lejen e planifikuar ankuesi për vitin 2019.

3. Në vijim, nëpërmjet e-mailit të datës 27.10.2021, të Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, të Bashkisë Lezhë, F. Gj, Komisioneri u informua se:

“Në dosjen personale të ish-punonjësit A. Gj si dhe në rregjistrin e lejeve vjetore të punonjësve nuk ka kërkesë për leje vjetore apo leje vjetore të kryer, për vitin 2018 dhe vitin 2019”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm të ankuesit nga ana e Bashkisë Lezhë.

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me parashikimet ligjore ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e ankuesit, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar⁵ dhe Kodi i Punës, i ndryshuar⁶, kanë saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast Bashkisë Lezhë, e cila duhet të provonte se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, për shkakun e pretenduar prej tij.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“ Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”*.

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij”*.

⁵Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

⁶Kështu, neni 9, pika 10 e tij, përcakton se: *“10. Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë”*.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Nga këqyrja e dokumentacionit dhe kronologjia e ngjarjeve dhe fakteve rezulton se:

Subjekti ankues ka lidhur marrëdhëniet e punës me Bashkinë Lezhë, me datë 01.01.2017, nëpërmjet kontratës individuale të punës, me afat të caktuar (nga data 01.01.2017-01.06.2017), në detyrën “Elektrici” në Sektorin e Shërbimeve, pranë Bashkisë Lezhë.

Nëpërmjet Vendimit nr. 309, datë 03.08.2017 të Kryetarit të Bashkisë Lezhë, ankuesi është emëruar “Punëtor” në Sektorin e Mirëmbajtjes së Institucioneve, në Agjencinë e Shërbimeve Publike, pranë Bashkisë Lezhë.

Nëpërmjet Vendimit nr. 387, datë 03.10.2017 të Kryetarit të Bashkisë, ankuesi është transferuar nga detyra “Punëtor” i Sektorit të Mirëmbajtjes së Institucioneve në Agjencinë e Shërbimeve Publike, në detyrën “Punonjës” në Agjencinë e Emergjencave Civile, pranë Bashkisë Lezhë.

Me Urdhrin nr. 472, datë 16.09.2019 “Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës”, ankuesit, me detyrë “Punonjës” në Agjencinë e Emergjencave Civile, pranë Bashkisë Lezhë, i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës, për arsye të mosparaqitjes në punë, për më shumë se 30 ditë, pa shkaqe të justifikuara.

Sikurse evidentohet nga aktet e mësipërme, pretendimi i ankuesit se ka lidhur marrëdhëniet e punës me Bashkinë Lezhë që në vitin 2015, në pozicionin “Specialist i Marrëdhënieve me Publikun”, detyrë të mbajtur deri më muajin gusht 2019, nuk qëndron dhe është i pabazuar në asnjë akt shkresor.

Referuar “Librit të Dorëzimit të Dokumentave nga Sekretaria dhe anasjelltas” të Bashkisë Lezhë, rezulton se subjekti ankues, me datë 16.09.2019 ka firmosur që ka marrë në dorëzim shkresën me nr. 89/471 prot., datë 16.09.2019 (*Urdhri sipërcituar*). Në këtë kontekst, Komisioneri gjen të pabazuar pretendimin e tij se nuk disponon asnjë dokument për largimin e tij nga puna.

Referuar Listë-pagesave të muajve korrik 2019 dhe gusht 2019, të Bashkisë Lezhë, rezulton se ankuesi ka munguar në punë dhe nuk është paguar për këtë periudhë.

Nga ana tjetër, nga verifikimet e bëra nga Bashkia Lezhë, për vitin 2019, rezulton që ankuesi nuk ka qenë me leje të planifikuar vjetore.

Për rrjedhojë, në kushtet, kur vetë ankuesi nuk provon të kundërtën, apo që minimalisht të provonte që kishte njoftuar në mënyrë shkresore apo ndonjë mënyrë tjetër eprorin e tij apo Burimet Njerëzore të Institucionit, që këta të fundit të ishin në dijeni të arsyes së mungesës së tij;

Komisioneri vlerëson si të bazuar dhe të drejtë shkëputjen e marrëdhënieve të punës me të, nga ana e punëdhënësit, Bashkisë Lezhë.

Mbështetur në dispozitat e Kodit të Punës, janë parashikuar disa mënyra të zgjidhjes së marrëdhënieve të punës nga punëdhënësi.

Neni 153, i Kodit të Punës, ka përcaktuar se:

“1. Punëdhënësi e punëmarrësi, në çdo kohë, mund të zgjidhin menjëherë kontratën për shkaqe të justifikuara. 2. Vlerësohen si shkaqe të justifikuara të gjitha rrethanat e rënda që nuk lejojnë, sipas parimit të mirëbesimit, t’i kërkohet atij që ka zgjidhur kontratën, vazhdimin e marrëdhënieve të punës”.

Neni 165, pika 1, e Kodit të Punës, ka përcaktuar se:

“1. Kur kontrata e punës zgjidhet nga punëdhënësi, për arsye se provohet se punëmarrësi nuk paraqitet në vendin e punës, të caktuar në kontratën e punës, ose e braktis atë menjëherë, pa shkaqe të arsyeshme, dhe brenda 7 ditëve nuk ka njoftuar, me shkrim, punëdhënësin, ajo konsiderohet si zgjidhje e pajustificuar e kontratës së punës nga ana e punëmarrësit”.

Kontrata e punës është një marrëveshje kontraktuale ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit që rregullon marrëdhëniet e punës dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve.

Kontrata Individulae mes punëdhënësit dhe punëmarrësit ka parashikuar gjithashtu, se punëdhënësi dhe punëmarrësi në çdo kohë mund të zgjidhin kontratën e punës për shkaqe të justifikuara. Vlerësohen si shkaqe të justifikuara, sipas përcaktimeve të kontratës, të gjitha rrethanat e rënda që nuk lejojnë, sipas parimit të mirëbesimit, t’i kërkohet atij që ka zgjidhur kontratën, vazhdimin e marrëdhënies së punës. Konsiderohen shkaqe të justifikuara, në favor të punëdhënësit, rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të rëndë, siç është rasti i mungesës së paarsyeshme të ankuesit në punë, për më shumë se 30 ditë pa lajmëruar punëdhënësin për arsyet e saj.

Bazuar në listë pagesat e muajve korrik dhe gusht 2019, rezulton që ankuesi ka munguar në punë. Gjithashtu, nuk rezulton e provuar në ndonjë akt, dëshmi apo provë tjetër, që ai të ketë lajmëruar punëdhënësin lidhur me arsyet e mungesës së tij në vendin e punës. Në këto kushte, ankuesi nuk është paraqitur në vendin e punës për më shumë se 30 ditë, pa lajmëruar lidhur me mungesën e tij apo për arsyet e saj dhe nga ana e Bashkisë, me të drejtë, është konsideruar si shkelje shumë e rëndë e kontratës së punës, duke braktisur vendin e punës për më shumë se 30 ditë, pa njoftuar për ndonjë shkak të arsyeshëm lidhur me mosparaqitjen e tij në detyrë.

Për rrjedhojë, në analizë të sa më sipër, Komisioneri gjykon se, nga ana e Bashkisë Lezhë nuk ka patur veprime të padrejta, të pafavorshëm apo të paligjshme lidhur me arsyetimin dhe motivacionin e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës me ankuesin, dhe se kjo masë, si pjesë e mjeteve ligjore për

mbrojtjen e punëdhënësit, në rastet kur punëmarrësi nuk i respekton rregullat dhe normat kontraktore dhe ligjore është marrë proporcionalisht me natyrën e shkeljes.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.”*.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”.

Në nenin 12/1/c) të ligjit nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimit dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”*.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se ankuesi nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Lezhë.

Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Bashkisë Lezhë, për shkakun e pretenduar nga subjekti ankues.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, nenin 32, pika 1/c), si dhe nenin 33, pika 10 të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të A. Gj, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Bashkisë Lezhë, në të drejtën për punësim.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Punësim

Shkaku: Bindjet politike

Lloji i vendimit: Mosdiskriminim